



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-IV.-14-3956

Parashtruesi i ankesës:

I. H, Podujevës

Kundër

Pala kundërshtare:

Ndërmarrja Shoqërore F "Z P", Podujevë, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. "Agim Ramadani", Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme) gjyqtarja Manushe Karaçi më 26 maj 2020, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

I. Ankesa refuzohet si e pabazuar ndërsa vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN046-0535 i datës 4 gusht 2014, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

II. Në këtë çështje juridike nuk caktohen taksa gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 11 gusht 2014 Dhoma e Posaçme ka pranuar ankesë nga Parashtruesi i ankesës kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, me të cilën kërkon kompensimin e kontributeve pensionale në shumën prej 462.04€, për periudhën prej vitit 2002 deri më 2005 nga Ndërmarrja Shoqërore F "Z P", Komuna e Podujevës.

Kësaj ankese parashtruesi si provë i ka bashkëngjitur:

- *Kopjen e vendimit të AKP-së sipas kërkesës PRN046-0535 të datës 4 gusht 2014, për refuzimin e kërkesës së paraqitur nga Parashtruesi i ankesës;*

- *Kopjen e gjendjes së trustit pensional të papaguar;*
- *Kopjen e njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 24 mars 2006;*
- *Formularin për parashtrimin e kërkesës jo-pronësore në likuidim.*

Parashtruesi i ankesës kishte paraqitur kërkesë të afatshme pranë Autoritetit të Likuidimit më 9 tetor 2013, për kompensimin e kontributeve pensionale në shumën prej 462.04€, për periudhën prej vitit 2002 deri më 2005 nga Ndërmarrja Shoqërore F "Z P", Komuna e Podujevës.

Më 4 gusht 2014 Agjencia Kosovare e Privatizimit nxjerr vendimin sipas kërkesës PRN046-0535, me të cilin refuzon kërkesën e parashtruesit të ankesës si të pavlefshme.

Sipas AKP-së për të ndërprerë parashkrimin kërkesa do të duhej të paraqitej në gjykatë apo ndonjë organ kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur parashtruesit i ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin e kontributeve pensionale, pra tre vite nga dhjetori 2002.

AKP-ja e refuzon kërkesën si të pavlefshme duke ju referuar Nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në dhe Nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas Nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, që parashikon që ‘pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër e punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre vjet’.

AKP-ja gjithashtu thekson se ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë të parashtrimit të ndonjë ankese apo kërkesë në ndonjë gjykatë apo autoritet kompetent para përfundimit të periudhës së parashkrimit.

Në bazë të Nenit 37 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjyqtarja e Dhomës së Posaçme nxjerr një urdhër me të cilin ankesa e dorëzuar nga parashtruesi i ankesës i dërgohet AKP-së për përgjigje në ankesë.

Më 17 mars 2020 AKP-ja dorëzon mbrojtjen e saj ndaj ankesës së parashtruesit të dorëzuar më 11 gusht 2014 kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN046-0535 të NSH-së F "ZP" (në likuidim).

AKP-ja përmes mbrojtjes së saj kërkon nga Dhoma e Posaçme që të refuzojë ankesën si të papranueshme dhe/ose të pabazuar, dhe të vërtetojë (lë në fuqi) Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN046-0535 të datës 4 gusht 2014.

Arsyvetimi Ligjor

Vendimi lëshohet pa mbajtur seancë dëgjimore sepse faktet dhe provat e deponuara në lëndë janë mjaft të qarta, andaj gjyqtari individual nuk pret që në seancë të ketë më tepër informacione dhe argumente në kuptim të nenit 72 paragrafi 11 të Ligjit të DHPGJSK (Nr. 06/L-086).

Ankesa e parashtruesit refuzohet si e pabazuar ndërsa vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN046-0535 i datës 4 gusht 2014, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Interpretimi i mësipërm është në linjë me jurisprudencën e qëndrueshme të Dhomës së Posaçme. *[Shih, për shembull Aktgjykimet C-IV-13-2611 të datës 14 qershor 2016, C-IV-13-2514 të datës 13.05.2016, C-IV-14-0532 të datës 09.08.2016, AC-I-15-0253 të datës 27.09.2016 etj.*

Në bazë të shkresave të lëndës Gjykata vëren se paditësi ka parashtruar ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për kompensimin e kontributeve pensionale në shumën prej 462.04€, për periudhën prej vitit 2002 deri më 2005 nga Ndërmarrja Shoqërore F "Z P", Komuna e Podujevës.

Gjykata vlerëson parashtruesi i ankesës do të duhej të parashtronte kërkesën e tij për kompensim brenda tri viteve nga dhjetori 2002 kur atij NSH-ja nuk ia ka paguar kontributet pensionale

Sipas vlerësimit të Gjykatës kërkesa e parashtruesit të ankesës lidhur me kompensimin e kontributeve pensionale është parashkruar në dhjetor të vitit, ndërsa kërkesa e tij është parashtruar më 9 tetor 2013.

Në bazë të dispozitës së mësipërme ligjore kërkesa nga ana e paditësit do të duhej të parashtrohej pranë ndonjë gjykate apo autoriteti kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur parashtruesi e kishte fituar të drejtën për të kërkuar kompensimin në fjalë.

Duke ju referuar provave në shkresa të lëndës gjykata gjen se paditësi nuk ka parashtruar kurrfarë dëshmie se iu është drejtuar ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda tre viteve para dhjetorit të vitit 2005 për të ndërprerë afatin e parashkrimit.

Neni 36.2 nënparagrafi 1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në parasheh që *"...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ...kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme"*.

Sipas Nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 53 të vitit 1976) i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, parashikon se: *'pagesa e shumës së pagës apo rrogës, ose të ndonjë kërkese tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet'*.

Për më tepër edhe Neni 137 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 1978 gjithashtu e parasheh afatin e njëjtë kohor për parashkrimin e të gjitha kërkesave me para si rezultat i marrëdhënies së punës.

Në bazë të nenit 31, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës i cili përcakton se: *'Palët, në parashtrësat e tyre me shkrim, duhet të*

paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës’.

Me nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parashihet që: *‘në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore’.*

Sipas nenit 7, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore parasheh që: *Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.*

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile ankesa është e pabazuar.

Duke pasur parasysh afatin e parashkrimit në bazë të dispozitave të lartcekura ligjore Gjykata ishte e obliguar që padinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar ashtu siç u tha në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet Gjyqësore:

Duke u bazuar në Nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Në bazë të Nenit 13, paragrafi 13.3 i Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, në këtë lëndë ankuesi nuk ngarkohet me pagesën e taksës gjyqësore sepse lartësia e shumës së kërkuar me padë është nën 1,000.00 euro.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

GJYQTARJA,
Manushe Karaçi